

Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Kreu 1, Pika 1	Bordi i institucionit arsimor publik dhe privat (në vijim bordi), ka në përbërje të tij përfaqësues nga nxënësit, prindërit, mësuesit, si dhe përfaqësues të komunitetit, të njësisë arsimore vendore dhe të njësisë së vetëqeverisjes vendore.		
Kreu 1, Pika 2	Bordi ka siguruar që shërbimi arsimor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit, nëpërmjet njohjes së problemeve, zgjidhjes ose adresimit për zgjidhjen e tyre. Bordi ka kontribuar për mbarëvajtjen e IA-së, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.		
Kreu 1, Pika 3	Bordi, për realizmin e misionit të tij, ka bashkëpunuar me partnerë brenda dhe jashtë institucionit arsimor, njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe me njësinë arsimore vendore.		
Kreu 2, Pika 1	Përfaqësuesi i njësisë arsimore vendore ka ngritur bordin.		
Kreu 2, Pika 2	Titullari i njësisë arsimore vendore ka siguruar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, listën e përfaqësuesve të tyre në bordet e institucioneve arsimore përkatëse.		
Kreu 2, Pika 3	Përfaqësuesi i njësisë arsimore vendore ka drejtuar mbledhjet e këshillit të mësuesve për zgjedhjen e mësuesit në bord dhe ka organizuar përfshirjen në bord të pjesëtarëve të tjerë nga komuniteti.		
Kreu 3, Pika 1	Bordi ka kryetarin dhe sekretarin e tij.		
Kreu 3, Pika 2	Bordi përbëhet nga: <ul style="list-style-type: none"> - përfaqësues të prindërve të nxënësve; - përfaqësues të mësuesve; - përfaqësues të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse; - nxënës; - përfaqësues të komunitetit/komuniteteve (me ndikim në jetën komunitare, përfaqësues nga bota e biznesit, përfaqësues të OJF-ve, të interesuar për mbarëvajtjen e institucionit, por që nuk janë prindër). 		
Kreu 3, Pika 3	Bordi është ngritur duke i kushtuar kujdes të veçantë: <ul style="list-style-type: none"> - përfaqësimit gjinor; - pakicave kombëtare; - grupeve të tjera të veçanta. 		
Kreu 3, Pika 4	Drejtori i institucionit arsimor nuk bën pjesë në bord.		

Kreu 3, Pika 5	Bordi përbëhet nga 7 vetë, përkatësisht: 1 mësues, 2 prindër, 2 nxënës, 1 pjesëtar tjetër i komunitetit dhe 1 përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse. Kur në bord nuk ka nxënës, ai përbëhet nga: 1 mësues, 3 prindër, 2 pjesëtarë të tjerë të komunitetit dhe 1 përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.		
Kreu 3, Pika 6	Bordi ka si anëtarë: <ul style="list-style-type: none"> - prindër të zgjedhur me shumicë votash të fshehta nga këshilli i prindërve; - mësues të zgjedhur me shumicë votash të fshehta nga këshilli i mësuesve; - nxënës të zgjedhur me shumicë votash të fshehta nga qeveria e nxënësve; - pjesëtarë të komunitetit të përfshirë në bord me nismën e tyre dhe të përzgjedhur me votim të fshehtë nga anëtarët e tjerë të bordit. Mandati i përfaqësuesve të prindërve, nxënësve dhe mësuesve shoqërohet me kopje të procesverbalit të organit që i ka përzgjedhur.		
Kreu 3, Pika 7	Përfaqësuesi në bord i njësisë së vetëqeverisjes vendore, është caktuar nga këshilli i saj.		
Kreu 3, Pika 8	Përfaqësuesi i ZVAP-it ose i deleguari nga ky institucion, ka marrë pjesë në mbledhjen e konstituimit të bordit, pa të drejtë vote.		
Kreu 3, Pika 9, Gërma b	Kryetari dhe anëtarët e bordit nuk kanë lidhje familjare me drejtorin e IA-së (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes).		
Kreu 3, Pika 9, Gërma a	Kryetari dhe anëtarët e bordit nuk kanë precedentë penalë.		
Kreu 4, Pika 1, Gërma a	Bordi i ka kërkuar drejtorit të IA-së t'i raportojë për kushtet e të nxënësve, për arritjet e nxënësve dhe për aspekte të zbatimit të legjislacionit në institucion.		
Kreu 4, Pika 1, Gërma b	Bordi ka ftuar për t'u kërkuar mendim nëndrejtorët, mësuesit, kryetarin e këshillit të prindërve, kryetarin e qeverisë së nxënësve, ekspertë të arsimit dhe përfaqësues të OJF-ve.		
Kreu 4, Pika 1, Gërma c	Bordi u është drejtuar me shkrim ose ka takuar përfaqësues të njësisë arsimore vendore dhe të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për përmirësimin e kushteve të të nxënësve në institucion.		
Kreu 4, Pika 1, Gërma d	Bordi, në raste të veçanta, ka komunikuar drejtpërdrejt me organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, në lidhje me aspekte problematike të zhvillimit veprimtarisë së IA-së.		
Kreu 4, Pika 1, Gërma e	Bordi ka ndërtuar dhe ka forcuar një partneritet veprues "institucion arsimor-prindër-komunitet" për të përmirësuar mjedisin në shkollë.		

Kreu 4, Pika 1, Gërma f	Bordi ka nxitur ofrimin e shërbimeve dhe mbështetje për familjet në nevojë.		
Kreu 4, Pika 1, Gërma g	Bordi ka rritur aftësitë e prindërve dhe rolin ndikues të tyre në edukimin e fëmijëve.		
Kreu 5, Pika 1, Gërma a	Bordi ka miratuar planin afatmesëm dhe vjetor të institucionit.		
Kreu 5, Pika 1, Gërma b	Bordi ka miratuar planin e shpenzimeve të institucionit arsimor për fondet, të cilat sigurohen nga institucioni.		
Kreu 5, Pika 1, Gërma c	Bordi ka miratuar kurrikulën e hartuar nga institucioni arsimor.		
Kreu 5, Pika 1, Gërma d	Bordi ka marrë pjesë në procedurat e emërimit dhe largimit të drejtorit të institucionit arsimor dhe të mësuesit.		
Kreu 5, Pika 1, Gërma e	Bordi ka shqyrtuar rregulloren e brendshme të institucionit.		
Kreu 5, Pika 1, Gërma f	Bordi ka miratuar hapjen dhe mbylljen e shërbimeve të institucionit për të tretët.		
Kreu 5, Pika 1, Gërma g	Bordi ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të institucionit.		
Kreu 5, Pika 1, Gërma h	Bordi ka ndjekur përmbushjen e objektivave të planit vjetor të institucionit.		
Kreu 5, Pika 1, Gërma i	Bordi ka përfaqësuar shqetësimet e qytetarëve dhe të prindërve të drejtuesit dhe/ose administratorët e institucioneve arsimore për të përmbushur nevojat e nxënësve/fëmijëve.		
Kreu 5, Pika 1, Gërma j	Bordi ka përfaqësuar shqetësimet e institucionit arsimor të qytetarët, të tatimpaguesit dhe të prindërit në komunitet.		
Kreu 5, Pika 1, Gërma k	Bordi ka nxitur dhe ka mbështetur zbatimin e nismave gjithëpërfshirëse në dobi të nxënësve/fëmijëve dhe të komunitetit.		
Kreu 5, Pika 1, Gërma l	Bordi ka monitoruar dhe ka vlerësuar institucionin arsimor, në mënyrë që bordi të mund të marrë vendime në vazhdim.		
Kreu 5, Pika 1, Gërma m	Bordi ka propozuar dhe ka sjellë në vëmendje të drejtorisë së institucionit arsimor, të njësisë arsimore vendore dhe të njësisë së vetëqeverisjes vendore, çështje që kanë të bëjnë me nevoja të identifikuar nga prindër, nxënës, mësues apo aktorë të tjerë të komunitetit.		
Kreu 5, Pika 2	Bordi është përpjekur që të sigurojë kontribute të ligjshme vendase ose të huaja, për mbarëvajtjen e institucionit.		
Kreu 5, Pika 3	Bordi ka realizuar në tetor dhe në mars dy takime të përbashkëta me këshillin e prindërve të institucionit për veprimtarinë e tij.		
Kreu 5, Pika 4	Bordi u ka dërguar raportin e hartuar në fund të vitit shkollor: <ul style="list-style-type: none"> - këshillit të prindërve; - qeverisë së nxënësve; 		

	<ul style="list-style-type: none"> - njësisë arsimore vendore; - njësisë së vetëqeverisjes vendore. 		
Kreu 6, Pika 1	Bordi është zgjedhur një herë në tre vjet dhe përsëritja e mandatit nuk ka qenë e kushtëzuar. Mandati i përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore është bërë njëherë në katër vjet me të drejtë rizgjedhjeje.		
Kreu 6, Pika 2	Bordi është mbledhur jo më pak se tri herë në vit. Bordi ka zhvilluar mbledhje të tjera me nismën e kryetarit ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij.		
Kreu 6, Pika 3	Mbledhja e bordit, me përjashtim të mbledhjes së parë të krijimit të tij, e cila kërkon detyrimisht pjesëmarrjen e 3/5 të anëtarëve të tij, është zhvilluar kur kanë marrë pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të bordit.		
Kreu 6, Pika 4	Bordi ka marrë vendimet me shumicë të thjeshtë votash, të cilat janë nënshkruar nga kryetari dhe sekretari i tij.		
Kreu 6, Pika 5	Kryetari ose anëtari i bordit është larguar nga bordi, kur gjatë dy viteve të njëpasnjëshme, ka munguar në të paktën gjysmën e mbledhjeve të tij. Sekretari i bordit ka njoftuar me shkrim institucionin/organin përkatës, për largimin e përfaqësuesit të tij nga bordi. Zëvendësimi i përfaqësuesit është kryer nga të njëjtat organe/institucione brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, sipas procedurave të përshkruara në këtë udhëzim.		
Kreu 7, Pika 1	Bordi (si rregull) drejtohet nga një prind, i cili është kryetari i bordit.		
Kreu 7, Pika 2	Kryetari i bordit nuk është mësues.		
Kreu 7, Pika 3, Gërma a	Kryetari i bordit është zgjedhur në mbledhjen e parë të bordit me shumicën e thjeshtë të votave të fshehta.		
Kreu 7, Pika 3, Gërma b	Kryetari i bordit ka drejtuar veprimtarinë e bordit.		
Kreu 7, Pika 3, Gërma c	Kryetari i bordit ka drejtuar ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve të bordit.		
Kreu 7, Pika 3, Gërma d	Kryetari i bordit ka drejtuar hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të bordit.		
Kreu 7, Pika 4, Pika 4	Kryetari i bordit është shkarkuar me shumicë të thjeshtë të votave të fshehta të anëtarëve të bordit, për moskryerje të detyrave të tij.		
Kreu 8, Pika 1, Pika 1	Bordi ka si sekretar, mësuesin, anëtar të tij.		
Kreu 8, Pika 2, Gërma a	Sekretari i bordit ka përgatitur materialet që shpërndahen në mbledhjen e bordit.		
Kreu 8, Pika 2, Gërma b	Sekretari i bordit ka mbajtur shënimet e mbledhjeve të bordit.		

Kreu 8, Pika 2, Gërma c	Sekretari i bordit ka lajmëruar anëtarët e bordit dhe të ftuarit për mbledhjen e radhës.		
Kreu 8, Pika 2, Gërma d	Sekretari i bordit ka mbajtur arkivin e bordit në një mjedis të institucionit.		
Kreu 8, Pika 3	Sekretari i bordit ka përcjellë informacionin te njësi arsimore vendore, për minutat e mbledhjes, jo më vonë se 3 ditë mbas mbledhjes së bordit.		
Kreu 9, Gërma a	Drejtori i institucionit ka promovuar politikat për zhvillimin e standardeve profesionale në aspektet e sigurisë dhe shëndetit, gjatë realizimit të procesit mësimor dhe jashtë tij në veprimtarinë komunitare.		
Kreu 9, Gërma b	Drejtori i institucionit i ka dorëzuar kryetarit të bordit kopje të urdhrave, udhëzimeve dhe rregulloreve të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe të institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, që i përkasin veprimtarisë së institucionit.		
Kreu 9, Gërma c	Drejtori i institucionit i ka raportuar bordit për çështje të mbarëvajtjes së shkollës, për të cilat kryetari i bordit i ka paraqitur kërkesë me shkrim.		
Kreu 9, Gërma d	Drejtori i institucionit i ka dorëzuar kryetarit të bordit një kopje të raportit të inspektimit, rezultatet e nxënësve në provimet kombëtare dhe çdo studim që krahason institucionin me institucionet e tjera arsimore.		
Kreu 9, Gërma e	Drejtori i institucionit i ka siguruar bordit një mjedis për zhvillimin e takimeve dhe për arkivin e tij.		